



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 216, Datë 28.07.2026

MBI

**MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
PËR ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E REKOMANDIMEVE TË
REZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË
ENERGJISE MIRATUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; Pjesës I, Kreu II, pika 1 të vendimit nr. 134/2018, të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm, me nr. 2222 prot., datë 27.07.2026 “Mbi miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2026”,

Konstatoi se:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me shkresën me nr. 1334/3 prot., datë 23.07.2026, protokolluar në ERE me 999/1 prot., datë 24.07.2026, ka përcjellë në ERE Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026”, në të cilën, krahas vlerësimit të veprimtarisë së institucionit, janë adresuar rekomandime konkrete për forcimin e rolit rregullator të ERE-s dhe përmirësimin e performancës së saj në funksion të zhvillimit të sektorit të energjisë.
- Me vendimin nr. 134/2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar “Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik”, i cili përcakton mekanizmin për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj. Ky dokument shërben për zbatimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.
- Rekomandimet e Rezolutës për vitin 2026 adresojnë, ndër të tjera, forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve të energjisë nëpërmjet funksionalizimit të platformës digjitale për administrimin dhe ndjekjen e ankesave, përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit të operatorëve të sistemit, harmonizimin e kuadrit rregullator me acquis communautaire të Bashkimit Evropian, monitorimin e planeve të investimeve të operatorëve të sistemit, zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, monitorimin e funksionimit të bursës ALPEX,

standardizimin e raportimit të bilanceve energjetike, rritjen e transparencës dhe informimit publik, si dhe promovimin e integritetit të vetëprodhuesve në treg.

- Në këtë kuadër, ERE ka përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, i cili përbën një instrument administrativ dhe menaxherial për organizimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në Rezolutë. Për secilin rekomandim janë përcaktuar veprimet konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe treguesit për monitorimin e përmbushjes së tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Planit të Veprimit të Entit Rregullator të Energjisë për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026”, sipas dokumentit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Çdo strukturë përgjegjëse e përcaktuar në Planin e Veprimit të raportojë periodikisht, brenda datës 5 të çdo muaji, bordit, mbi ecurinë e zbatimit të masave dhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve përkatëse, në përputhje me detyrat dhe afatet e përcaktuara në Planin e Veprimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për koordinimin e punës ndërmjet strukturave përgjegjëse, për ndjekjen e zbatimit të Planit të Veprimit, si dhe për përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve periodike për bordin e ERE-s mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë strukturat përkatëse për këtë vendim

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Plani i Veprimit

mbi

IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË “PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026”

MIRATUAR ME VENDIMIN
NR. 216, DATË 28.07.2026 TË BORDIT TË ERE-S

Nr.	Detyra sipas Rezolutës	Veprimi	Afati i veprimit	Struktura përgjegjëse	Treguesi i realizimit
1	Funksionalizimi i Platformës Digjitale për trajtimin dhe gjurmimin e ankesave të konsumatorëve.	Nisja e procedurës së prokurimit	Qershor-Shtator 2026	Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT), Drejtoria Ekonomike dhe Financës	Shpallja e procedurës Marra e ofertave Vlerësimi i ofertave
		Përfundimi i procedurës së prokurimit të platformës	Shtator 2026	Sekretari i Përgjithshëm	Firmosja e kontratës me zhvilluesin e platformës
		Zhvillimi i platformës sipas kërkesave të specifikimeve teknike	Shtator-Dhjetor 2026	Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT), Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe e Zgjidhjes Alternative të Ankesave	Bërja efektive e platformës
		Publikimi dhe vënia në funksion e platformës	Dhjetor 2026	Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT), Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe e Zgjidhjes Alternative të Ankesave	Testimet me operatorët Bërja efektive e platformës
2	Masa rregullatore për përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes.	Analiza e performancës së operatorëve sipas KPI-ve	Periodik tremujor	Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimit të Shërbimit Publik	Raport tremujor Bordit
		Monitorimi dhe evidentimi i realizimit ose mosrealizimit të treguesve SAIDI, SAIFI, ENS	Mujor	Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimit të Shërbimit Publik	Raporte monitorimi Bordit për muajt paraardhës Rekomandime
		Përgatitja e ndryshimeve rregullatore	Brenda 60 ditëve	Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimit të Shërbimit Publik; Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve	Propozime për ndryshime në rregulloret përkatëse, përfshirë marrjen e masave administrative
3	Harmonizimi i legjislationit kombëtar me acquis-n e BE-së: transpozimi i Paketës së Integrimit të Energjisë (EIP) dhe liberalizimi i plotë i tregut me pakicë.	Evidentimi i akteve që kërkojnë transpozim	Korrik 2026	Drejtoritë	Përpilimi i një plani masash për aktet e nevojshme për miratim
		Hartimi i projektakteve	Sipas kalendarit	Grupe pune me përfshirjen e niveleve të larta drejtuese (Anëtar Bordi, SP dhe Drejtoritë) sipas natyrës së akteve rregullatore që burojnë nga hyrja në fuqi e ligjit	Nxjerrja e Urdhrave për ngritjen e Grupeve të Punës me personat përgjegjës
		Konsultimi publik dhe institucional	Sipas ligjit	Grupet e punës	Konsultime me palët e interesit.
		Miratimi i akteve rregullatore	Brenda afateve të përcaktuara në ligj	Grupet e punës	Vendime
4	Fokus, gjatë shqyrtimit të planeve të investimeve të OSSH/OST, në rritjen e kapaciteteve transmetuese, fleksibilitetin operacional dhe furnizim të qëndrueshëm	Shqyrtimi i planit të investimeve dhe vijimi i korrespondencës me operatorët për çështjet sipas detyrave të rezolutës	Në vijim	Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave	Raportim në Bord mbi gjetjet paraprake dhe propozime për shqyrtimin, përfshirë korrespondencën me OSSH sh.a.

	në zona me intensitet të lartë zhvillimi (përfshirë zonat turistike).				
		Përgatitja e propozimit respektiv për Bordin sa i takon aplikimit të OSSH	Shtator 2026	Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave	Relacion dhe projektvendim
		Vijim i korrespondencës me OST lidhur me hartimin dhe përcjelljen e Planit të Zhvillimit 10-vjeçar	Shtator	Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave	Informacion në Bord
5	Vlerësimi i gatishmërisë së tregut të ditës në avancë, pas hyrjes në fuqi të metodologjisë përkatëse, duke përfshirë tregun e bashkuar Shqipëri – Kosovë.	Vijim i përgatitjes së Vlerësimit të radhës në bashkëpunim me ALPEX	Tetor 2026	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të siguruara nga ALPEX dhe nga Bursat rajonale
		Përgatitja e draftit dhe konsultimi me palët e interesit	Nëntor 2026	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme	Propozimi për vlerësim në Bord
6	Forcimi i monitorimit të Bursës ALPEX (transparencë, konkurrencë, efikasitet) dhe veprime rregullatore në rast devijimesh; rritje e vëllimit të tregtimit.	Mbikëqyrje e nivelit të transparencës dhe rritjes së volumeve	Në vijim	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme	Raportim periodik mujor në Bord dhe çdo 3 muaj në web
		Korrespondencë e vijueshme me ALPEX për dërgimin e të dhënave	Çdo muaj	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme	Përpunimi i bazës së të dhënave
		Propozimi i masave rregullatore	30 ditë nga konstatimi	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme	Relacion Projektvendim
7	Krijimi i një sistemi me template të standardizuara për raportimin e bilanceve energjetike nga operatorët e licencuar.	Rishikimi i template-ve të raportimit sipas parashikimeve të ligjit	Shtator 2026	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit	Propozim për shqyrtim në Bord
		Konsultimi me operatorët	Tetor 2026	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit	Njoftime dhe zhvillimi i seancave dëgjimore me palët
		Miratimi i template-ve	Nëntor 2026	Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit	Përgatitja e praktikës për relacion dhe projektvendim për miratim
		Krijimi i databazës elektronike	Dhjetor 2026	Spektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT)	Databaza
		Fillimi i raportimit standard	Dhjetor 2026	Të licencuarit / ERE	Fillim i testeve me të licencuarit
8	Zhvillimi i një hapësire të dedikuar në faqen zyrtare për materiale informuese/udhëzuese mbi eficiencën e energjisë.	Përgatitja e informacionit të dedikuar për eficiencën e energjisë	Shtator 2026	Grupi i Marrëdhënieve me Median, Spektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT)	Publikimi
		Përshtatje e faqes zyrtare të ERE dhe llogarive të saj në rrjetet sociale për të mundësuar aksesin e shpejtë dhe vizualizim të thjeshtë	Shtator 2026	Grupi i Marrëdhënieve me Median, Spektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT)	
		Përditësimi i materialeve	Në vijim	Grupi i Marrëdhënieve me Median, Spektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes (IT)	Publikime
9	Miratimi i çmimit sipas VKM nr. 368, datë 20.05.2026 dhe metodologjisë përkatëse.	Përgatitja e praktikës për shqyrtim në Bord për miratimin e çmimit sipas VKM nr. 368, datë 20.05.2026, dhe miratimit të metodologjisë	Dhjetor 2026	Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave	Projektvendim
10	Bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Kuvendit për zhvillimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës (KPI), si bazë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.	Zhvillim i korrespondencës siç do të kërkohej nga Kuvendi për metodologjinë e KPI-së.	Në vijim	Sekretari i Përgjithshëm	Informacion Bordit dhe dhënia e komenteve Kuvendit